# DËSHMI ARKIVI

**A-434864**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Balluku me vila luksoze në Palasë, zbardhen mesazhet me biznesmenin: Ka një “feeling” si jaht! Nëse s’t ë pëlqen e veshim me mermer blu |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/ka-nje-feeling-te-ngrohte-si-jaht-vilat-luksoze-ne-palase-e-maili-i-a-i103438` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 11:58:57 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 11:53:54 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | b58038133ed741396a90c2bffacb395822139de8a389325bd137a748c6870d45 |
| TEKSTI | 1da3ddb46354cf952287dc12f56b4c96b06c95180c3a74f7e3494c9d31defc4e |
| PAMJA | 2d792df4ceaa4e54dec8faa8697a90226125af65d8a465d4733a643310c4a3ff |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 5ca4a51f05d9e5498b7454b582310bf92e5e8fc9cde0bae9aeb3a5bd9505f504 |
| E MËPARSHMJA | 73b72d742d44a27310b4c420f7a99b4e3fe53a8441a11704b4701a6db476d20e |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5ca4a51f05d9e5498b7454b582310bf92e5e8fc9cde0bae9aeb3a5bd9505f504`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Balluku me vila luksoze në Palasë, zbardhen mesazhet me biznesmenin: Ka një "feeling" si jaht! Nëse s'të pëlqen e veshim me mermer blu

Piranjat Përditësimi i fundit 10 Shtator 2026, 13:53

Balluku me vila luksoze në Palasë, zbardhen mesazhet me biznesmenin:

Dy email-e të dërguara nga biznesmeni **Alban Eftimi** në adresë të ish-zv.kryeministres **Belinda Balluku** janë bërë pjesë e dosjes së SPAK, në kuadër të hetimeve për **vilën luksoze në Palasë,** për të cilën prokuroria dyshon se është përfituar si ryshfet në këmbim të tenderave publikë.

Sipas SPAK, e-maili i parë tregon komunikimin e drejtpërdrejtë të Eftimit me Ballukun për detaje të projektimit dhe arredimit të vilës, në një kohë kur objekti ishte ende në ndërtim.

Në një email të datës 14 shtator 2020, Eftimi i dërgon Ballukut një sërë detajesh për punimet në vilë, duke përshkruar edhe elementë të veçantë të projektit, nga pishina dhe vaskat hidromasazhi, te materialet e përdorura dhe mënyra e organizimit të ambienteve.

*"Një pjesë e mirë e ambienteve rreth pishinës janë veshur me 'teak' për një 'feeling' pak më të ngrohtë e pak si jaht"*, shkruan Eftimi në email.

Në të njëjtin komunikim ai përmend edhe mundësinë që vila të jepet me qira në të ardhmen, duke diskutuar për mënyrën se si ambientet duhet të krijonin ndjesinë e një hoteli luksoz.

*"Shkallët mes 2 godinave kanë gjelbërim kacavjerrës në të dy muret anësore"*, shkruan biznesmeni, ndërsa vijon me detaje për pishinën "infinity", tavolinën e ngrënies në nivel me ujin dhe hapësirat e parashikuara për vendosjen e gotave e pjatave.

Eftimi përshkruan gjithashtu dy vaska hidromasazhi të vendosura në krahët anësorë të vilave, si dhe përdorimin e materialeve prej "teak" për të krijuar një atmosferë të ngrohtë, të ngjashme me një jaht.

***"Po të dërgoj një rishikim. Kemi idenë që edhe nëse një ditë vendos ta japësh me qira, përdoruesit të mund të ndihen të llastuar njësoj si në hotel. Shkallët mes 2 godinave kanë gjelbërim kacavjerrës në të dy muret anësore. Në një krah të pishinës zbritet me shkallë dhe ka një tavolinë ngrënieje në një nivel me ujin që të shijohet në maksimum "infinity pool". Pishina në skajin drejt detit ka po ashtu një plan për të vendosur gota e ndonjë pjatë.***

***Në 2 krahët anësore të shtëpive në nivelin e hyrjes dhe suitave janë bërë 2 vaska hidromasazhi (shih hotel Roccabella në Santorini).***
***Suitat do i punojmë akoma me variante. Ndarjet e kuzhinës me soggiornon dhe të garderobës tek "master bedroom" janë fizarmonikë. Një pjesë e mirë e ambienteve rreth pishinës janë veshur me "teak" për një "feeling" pak më të ngrohtë e pak si jaht. Shihe si alternativë kur të përfundojmë dhe renderat dhe nëse s'të ngjit, kthehemi tek mermerët blu", thuhet në email.***

Katër ditë më vonë, më 18 shtator 2020, Eftimi i dërgon sërish Ballukut një dokument me emërtimin **"Vilat binjake Palasë"**. Dokumenti përbëhet nga 11 faqe dhe përmban planimetri dhe projekte të sipërfaqeve të dy vilave.

Sipas hetimeve të SPAK, vila me numër 188/1 në Palasë ishte ndërtuar deri në fazën e karabinasë me investimin e ish-futbollistit **Igli Tare.** Më pas, punimet e tjera të objektit dyshohet se janë marrë përsipër dhe financuar nga biznesmeni **Arbër Abazi,** pronar i kompanisë **"Alko Impex General Construction".**

Kjo kompani, së bashku me operatorë të tjerë ekonomikë, ka fituar tenderin për ndërtimin e lotit 7 të Unazës së Madhe të Tiranës.

SPAK e konsideron me rëndësi edhe lidhjen familjare mes Abazit dhe Ballukut. Sipas të dhënave të bëra publike nga hetimi, Abazi bashkëjeton me një të afërme të ish-zv.kryeministres.

Në kuadër të hetimeve, SPAK ka vendosur sekuestrimin e vilës në Palasë, ndërsa emri i Belinda Ballukut është regjistruar si person nën hetim për veprat penale të korrupsionit, pastrimit të parave dhe fshehjes së pasurisë.

Balluku është gjithashtu e pandehur në një tjetër çështje penale që lidhet me tenderat publikë, konkretisht për procedurat për ndërtimin e tunelit të Llogarasë dhe lotet e Unazës së Jashtme të Tiranës.

Hetimi për vilën në Palasë dhe komunikimet e zbuluara tashmë janë pjesë e një tjetër piste të SPAK, duke thelluar hetimet dhe rënduar akuzat ndaj ish-numrit dy të qeverisë Rama.

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 10 Shtator13:16

### ["Kërkojmë takim me Erion Veliajn në paraburgim", SPAK refuzon kërkesën e avokatëve të huaj]

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) ka refuzuar kërkesën e avokatëve britanikë p&eum...

AKTUALITET 10 Shtator13:00

### [Dëshmitë e punonjësve zbardhin çastet para shpërthimit të karburant "Eida", tre pista nën hetim]

Hetuesit e ngjarjes së ndodhur në stacionin e karburantit "EIDA" në zonën e Brrylit në Tiranë nuk kanë ende nj&...

AKTUALITET 10 Shtator12:44

**“Pse puthe të dashurin tim”/ U dhunua nga 3 vajzat në Fier, 17-vjeçarja rrëfen ngjarjen: Më futën në lokal me vrap**

17-vjeçarja e dhunuar pak muaj më parë, nga tre bashkëmoshatare në Fier, ka rrëfyer detaje mbi ngjarjen. Në një int...

Piranjat News AKTUALITET 10 Shtator12:08

**Skandal në Durrës/ Dyqan frutash në hyrje të pallatit, bllokohet aksesi për ambulancat dhe zjarrfikëset në rast emergjence**

Një tjetër rast që ngre pikëpyetje për ndërtimet dhe zënien e hapësirave të përbashkëta është...

AKTUALITET 10 Shtator12:05

**“Po mbytemi nga mbeturinat”/ Prej më shumë se 10 ditësh lagjja Magaze në Fushë-Krujë nuk pastrohet**

Një tjetër denoncim për situatën e mbetjeve urbane ka mbërritur në redaksinë e Piranjave News, këtë herë nga...

AKTUALITET 10 Shtator11:58

**Kontrolle ndaj makinave luksoze në Lezhë/ Bllokohet një “Rolls-Royce”, nis hetimi pasuror për pronarin me banim në Britani**

Strukturat e Policisë së Lezhës kanë nisur një aksion të përqendruar ndaj automjeteve luksoze që qarkullojnë n&eu...

AKTUALITET 10 Shtator11:54

**Arrestohet një shtetas dhe procedohen 15 të tjerë për veprime të kundërligjshme gjatë tubimit**

Një shtetas është arrestuar në flagrancë dhe 15 të tjerë janë proceduar penalisht pas veprimeve të kundërlig...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 10 Shtator11:50

**Erion Isai hap biznes, fut në bord Altin Bashën dhe miken e deputetes së Ramës**

Një shoqëri e re aksionere është hapur së fundi nga një institucion publik, siç është bashkia Kolonjë q&eu...

AKTUALITET 10 Shtator11:39

**Ngërçi me pagat, gjyqtarët kallëzojnë penalisht ministrin e Financave Petrit Malaj**

Gjyqtarë kanë depozituar kallëzim penal lidhur me mosekzekutimin e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve për muajin gusht 20...

AKTUALITET 10 Shtator11:36

**Dhunohet nga ‘të fortët’ drejtuesi i Ujësjellësit në Elbasan? Policia: Nuk ka bërë kallëzim, informacionin e morëm nga mediat**

Drejtori i Ujësjellësit të Elbasanit, Luan Tabaku, dyshohet se është dhunuar nga dy persona, ditën e dielë, në mes t&eum...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 9 Shtator

**Kush qëlloi i pari? Ekspertiza zbulon të vërtet...**

Dyshohet se ka qenë Valentina Pambianco ajo që ka marrë armën dhe ka tërhequr këmbëzën, duke vrarë bashkësho...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 9 Shtator

**Futën Ziza Pajazitin në burg/ Polici merret i p...**

Perent Lëngu, një punonjës me karrierë 18 vjeçare në burgun e Drenovës të Korçës, është marr&e...

POLITIKE 9 Shtator

**“Rama vuan nga narcizmi malinj”/ Lubonja: Skand...**

Analisti dhe publicisti Fatos Lubonja ka komentuar deklaratat e ish-zëvendëskryeministrit Arben Ahmetaj, duke bërë një vlerësim ...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

## video

## Reagon Cllevio!

**Reagon Cllevio!**

**Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!**

**Deklarata e Gjestit!**

**7 September 2026**

**Pamje apokaliptike nga Puka!**

**7 September 2026**

**Aida, piranja jonë e parë, rikthehet në skuadër më e motivuar se kurrë për të kapur maniakët.**

**Qytetarët na frymëzojnë çdo ditë. Bisedat e mikpritja e tyre na japin motiv për punën me pasion.**

**Luela Gaxhja, “stari” i Piranjave, që kërkon çdo ditë rritje rroge.**

**5 September 2026**

**5 September 2026**

**Florjan Binaj rikonfirmon: Do kandidoj sërish si kandidat i pavarur**

**Edon Kuqi/Piranja jonë politike që ngatërroi ëndrrën e gazetarit me atletin 100m.**

Dyshime për zjarrvënie të qëllimshme

Humbi jetën në aksidentin tragjik, një muaj më parë i propozoi për martesë.

Qytetarja denoncon me video ngacmimin ne autobus. #news

Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave

PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16

Gruaja me dy identitete që premton “shërim” me ujin e kufomave në Pejë

A ka Shqipëria një Nicola Gratteri?

Katër nëna në kërkim të fëmijeve/ Bisedat që zbuluan rrjetin e errët

Flamur Gjuzi, i dënuar për"shpërdorim detyre" sot drejtor i Policisë Bashkiake, sërish shkel ligjin?

Pallatet u zhytën“Durrës Marina" dhe Autoriteti Portual bëjnë veprimin e papritur përballë skandalit

Ekskluzive/ Nicola Gratteri çmonton skemën e pastrimit të parave të ndërtimit në Tiranë

PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 15

Enkel Demi duke luftuar paragjykimet për shqiptarët. (kamera e fshehtë)

Milva Ekonomi i firmosi miliona euro Vilma Nushit, kjo e fundit i investoi te kulla e Ervin Matës

Ajo çfarë mund të na mësojë Kosova.

Laboratorë “copy-paste”/ I njëjti mjek firmos analiza në disa pika, skema që ngre pikëpyetje

Rrjeti i ‘errët’ i vajzave të zhdukura! Bisedat tronditëse si funksiononte grupi.

Bleu 300 m2 tokë në vitin 2004, kthehet nga emigrimi dhe gjen aty vilë 3-katëshe.

“Na detyruan nga Dubai”/ Konstruktori i Durrës Marina zbulon pse u zhytën pallatet

Drejtori që tregon sjellje të pahijshme me nxënësen: Jam i fortë edhe në parti

PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 14

Turisti zemërgjerë nga Italia dhe patatinat falas

Aksidentet “pushtojnë” oborrin e familjes në Klos, banori: Një ditë do ndodhë tragjedi

Lidhja jashtëmartesore që përfundoi në makth /32-vjeçarja rrëfen shantazhin me video intime


Sherr në terminalin e Peshkopisë, shoferi: Mos më vidh pasagjerët! Shko ha bukë te pjesa jote

Artisti dhe Frika

Si u kthye në urrejtje dashuria mes ish-bashkëshortëve dhe 'lufta' për 200 mijë euro!

14-vjeçare me dr*gë dhepro*titucion, rrjeti i errët i minoreneve të zhdukura

Zhytja e pallateve te Alabarit/ IKMT pranon anomalitë në "Durrës Marina": Janë zhytur 28 cm

"Ederlezi", festa e veçantë e komunitetit rom

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.